

LIGJ**Nr. 8337, datë 30.4.1998****PER KALIMIN NE PRONESI TE TOKES BUJQESORE, PYJORE, LIVADHEVE DHE KULLOTAVE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave.

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE****V E N D O S I:****Neni 1**

Ky ligj synon rregullimin juridik të kalimit të pronësisë mbi tokën bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave për personat fizikë dhe juridikë shqiptarë.

Kalimi i pronësisë së tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave bëhet me akt noterial, sipas dispozitave të Kodit Civil.

Neni 2

Në kuptim të këtij ligji:

Tokë bujqësore është ajo tokë, që në çastin e kalimit të pronësisë konsiderohet e tillë në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën" dhe të akteve të tjera nënligjore.

Tokë pyjore është ajo tokë që në çastin e kalimit të pronësisë plotëson kriteret e ligjit nr. 7623, datë 13.10.1992 "Për pyjet dhe policinë e shërbimit pyjor" dhe të ligjit nr. 8118, datë 9.7.1996 "Për miratimin e dekretit nr. 1489, datë 16.5.1996 "Për një shtesë në ligjin nr. 8084, datë 7.3.1996 "Për miratimin me shtesa e ndryshime të dekretit nr. 1359, datë 5.2.1996 "Për disa ndryshime në dekretin nr. 1254, datë 19.10.1995 "Për kompensimin e ish-pronarëve të tokës bujqësore, jobujqësore dhe të trojeve të zëna, me troje në zonat turistike dhe në qendrat e banuara", ndryshuar me ligjin nr. 8024, datë 2.11.1995", si dhe të akteve të tjera nënligjore."

Tokë livadh dhe kullotë janë tokat që në çastin e kalimit të pronësisë plotësojnë kriteret e ligjit nr. 7917, datë 13.4.1995 "Për livadhet dhe kullotat" dhe të akteve të tjera nënligjore.

Neni 3

Toka bujqësore, pyjore, livadhet dhe kullotat, pronë e shtetit, nuk mund të tjetërsohen deri në kompensimin e ish-pronarëve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj.

Përrjashtim bëhet vetëm në rastet e kalimit të pronësisë për efekt të zbatimit të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve".

Neni 4

Kalimi i së drejtës së pronësisë të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave nuk iu njihet personave fizikë dhe juridikë të huaj. Personat fizikë dhe juridikë të huaj gëzojnë të drejtën e marrjes së saj me qira deri në 99 vjet. Dhënia me qira e tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave bëhet sipas dispozitave të Kodit Civil.

Neni 5

Familja bujqësore që i kalon pronësinë e saj mbi tokën bujqësore, pyjore, livadhet dhe kullotat çdo shtetasi, personi fizik dhe juridik vendas në përputhje me kërkesat ligjore për kalimin e pasurisë së paluajtshme, paraqet në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme dokumentet vijuese:

a) Çertifikatën e vërtetimit të pronësisë të zyrës së regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, shoqëruar me aktin noterial për kalimin e pronësisë dhe hartën treguese të vendodhjes së pronës.

b) Aktet që vërtetojnë përbërjen e familjes bujqësore në çastin e kalimit të pronësisë, të vërtetuar nga çertifikata e gjendjes civile, vërtetimi i pushtetit lokal dhe deklarata e përbashkët e anëtarëve të familjes.

c) Skicën topografike të pasurisë që do të jetë objekt i kalimit të pronësisë.

ç) Prokurën noteriale të përfaqësimit, kur kalimi i pronësisë nuk kryhet nga gjithë anëtarët e familjes bashkëpronarë të pasurisë së paluajtshme.

Neni 6

Një ose disa anëtarë të familjes bujqësore nuk mund të bëjnë kalimin e pronësisë të asnjë pjese të tokës bujqësore, pyjore, livadhe dhe kullota të familjes bujqësore, pa bërë më parë pjesëtimin e saj sipas dispozitave të Kodit Civil.

Neni 7

Veprimet për kalimin e pronësisë për pronat që nuk janë të regjistruara në bazë të ligjit nr. 7843, datë 19.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", mund të bëhen vetëm pasi të zbatohen rregullat e regjistrimit fillestar të pasurisë së paluajtshme.

Neni 8

Ligji nr. 7983, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e tokës bujqësore, livadheve dhe kullotave", si dhe çdo akt tjetër nënligjor që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2086, datë 12.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.